



Komuna e Klinës, Drejtoria e Arsimit-Komisioni përzgjedhës

04 NR. MM-4969 2024

Klinë, 15.02 2024

Duke u bazuar në neni 6 pika 5 nënpika 5.2 të Udhëzimit Administrative 07/ 2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik të MPMS, duke u bazuar në vendimin e drejtorit të DKA-së për përzgjedhjen e komisionit përzgjedhës nr. 04-112-42733/2023 i datës 22.12.2023, si dhe duke u bazuar në konkursin e jashtëm (publik) nr. 04-111-42160/2023 i datës 18.12.2023, Komisioni përzgjedhës më 15.02.2024 nxjerr këtë:

NJOFTIM

Anulohet konkursi konkursi i jashtëm (publik) nr. 04-111-42160/2023 i datës 18.12.2023 pasi që në këtë konkurs asnjëri nga kandidatet konkurrues nuk ka arrit 50% të pikëve në testin me shkrim të mbajtur me datën 26.01.2024.

ARSYETIM

Drejtoria e Arsimit në Klinë me datën 18.12.2023 kishte shpall konkurs të jashtëm (publik) për pozitën:
1 Mësimdhënës për Lëndët Profesionale të Mjekësisë në IAAP "Fehmi Agani" në Klinë normë e plotë 20 orë pozitë e lirë.

Komisioni përzgjedhës me datën 24.01.2024 ka publikuar njoftimin për test me shkrim.

Testi me shkrim është mbajtur me datën 26.01.2024 mirëpo asnjëri nga kandidatet me rastin e mbajtjes së testit me shkrim nuk kanë arritë 50% të pikëve të nevojshme.

Brenda afatit të paraparë ligjor komisioni ka arrit të i kontrolloj testet me shkrim dhe vërehet se asnjëri kandidat nuk e ka kaluar këtë test.

Me datën 02.02.2024 komisioni përzgjedhës ka publikuar listën me rezultate të testit me shkrim dhe sipas nenit 10 pika 6 të Udhëzimit Administrative 07/ 2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik të MPMS kandidateve konkurrent ju ka dhënë të drejtën që brenda afatit 3 ditë të paraqesin kërkesën e tyre për qasje në test.

Me datën 06.02.2024 njeri nga kandidatet kishte bërë kërkesë që të shikoj testin (të ketë qasje në test) pasi që i njëjti mendon se nuk është vlerësuar drejt.

Komisioni përzgjedhës me datën 14.02.2024 kandidatit ja ka mundësuar që të ketë qasje në test po sa i për këtë rezultatit të testit me shkrim nuk ka ndryshim.

Andaj bazuar në gjendjen faktike konkursi i lartcekur anulohet.

Ky njoftim ju dërgohet:

1. Drejtorit të DKA-së
2. Anëtare të komisionit përzgjedhës
3. Arkivit të DKA-së

Komisioni përzgjedhës

1. Astrit Muhaxheri

2. Uran Hasnaji

3. Sami Bardheci